

ÇKA ËSHTË LLOGARIA E PAGESËS ME SHËRBIME BAZIKE?



Kjo llogari ofron një grup shërbimesh bankare bazike, të cilat qytetarët e Kosovës mund t'i përdorin me kosto/çmime të ulta apo falas.



Kush mund të ketë llogari pagese me shërbime bazike?

Qasja në llogaritë e pagesave me shërbime bazike duhet të sigurohet për të gjithë qytetarët e Kosovës, pavarësisht nga rrethanat financiare të konsumatorëve, statusi i punësimit të tyre, niveli i të ardhurave, historia e kredisë ose falimentimi.

Banka duhet të sigurojë që qasja në një llogari pagese me shërbime bazike nuk kushtëzohet me blerjen e shërbimeve shtesë.



Cilat banka ofrojnë llogari pagese me shërbime bazike?

Të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), do të ofrojnë shërbimet e cekura në vijim, pa pagesë ose me një tarifë të arsyeshme mujore, 0,12% e vlerës së pagës mesatare neto mujore në Kosovë e publikuar më së fundmi nga ASK, e që për vitin 2023 kjo tarifë është jo më e lartë se 0.54 €.



Cilat shërbime i përfshin llogaria e pagesës me shërbime bazike?

1. Hapjen, operimin dhe mbylljen e një llogarie pagese; përfshirë edhe një kartelë debiti.

2. Deponimin e fondeve në llogari pagese.

3. Tërheqjen e parave nga llogaria e pagesës.

4. Një herë në muaj një pasqyrë të gjendjes së llogarisë.

5. Kryerjen e transaksioneve në vijim:

- debitimi direkt;
- transaksionet e pagesave përmes një kartele, përfshirë pagesat në internet;
- transferet e kreditit brenda bankës, duke përfshirë urdhëresat automatike, aty ku është e mundur në bankomatë (ATM) dhe në sportelet e bankës, ose përmes platformave online.



Kush përfiton pa pagesë këto shërbime?



Pa pagesë, do të përfitojnë kategoritë e konsumatorëve që i përkin grupit të konsumatorëve të cenueshëm që përfitojnë nga të drejtat e parashikuara me legjislacionin që rregullon pensionet dhe asistencën sociale në Kosovë.



Kush janë grupet e konsumatorëve të cenueshëm?

Grup i konsumatorëve të cenueshëm konsiderohen grupet që përfitojnë:

1. Përfitues të Pensioneve:

- Pensioni bazë;
- Pensioni kontribut pagues;
- Pensioni për persona me aftësi të kufizuar të rritur;
- Pensioni për persona me aftësi të kufizuar paraplegjik dhe tetraplegjik;
- Pensioni për persona me aftësi të kufizuar – fëmijë; Pensionet e parakohshme të kompleksit Trepça;
- Pensionet e pjesëtareve të TMK-së; Pensioni i forcës së sigurisë FSK-së;
- Kompensimi për të verbër;
- Pensioni familjar;
- Pensioni i invalidëve të punës;
- Pensioni i familjareve të dëshmorëve;
- Pensioni i invalidëve të luftës;
- Pensioni i viktimave civile;
- Pensioni i invalidëve civilë;
- Pensioni i të zhdukurve të luftës;
- Pensioni i veteranit luftëtar të UÇK-së;



2. Ndihma sociale;



A munden konsumatorët/klientët e bankave që të bëjnë konvertimin/shndërrimin e llogarive rrjedhëse aktuale në llogari pagese me shërbime bazike?



Po, konsumatorët ekzistues të cilët posedojnë llogari pagese, me kërkesë kanë të drejtë të konvertojnë llogarinë e tyre në llogari pagese me shërbime bazike nëse plotësojnë kushtet e parapara sipas rregullores për qasje në llogari pagese me shërbime bazike.

Me rastin e konvertimit të llogarisë aktuale, konsumatorit i ruhet numri i njejtë i llogarisë.

Për konvertimin e llogarisë së pagesës nuk aplikohet tarifë.



A munden konsumatorët/klientët e bankave të bëjnë konyertimin/shndërrimin e llogarive rrjedhëse aktuale në llogari pagese me shërbime bazike ?

- **Bankat duhet t'i ofrojnë llogari pagese me shërbime bazike të gjithë klientëve.**
- **Pa kufizime bazuar në gjendjen financiare ose kritere të tjera.**
- **Qasja nuk është kushtëzuar me blerjen e shërbimeve shtesë nga bankat.**
- **Hapja e llogarisë ose refuzimi duhet të ndodhë brenda 10 ditë pune.**
- **Refuzimi mund të ndodhë nëse hapja e llogarisë shkel rregullat në kuadër të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.**
- **Refuzimi ndodh nëse klienti ka tashmë një llogari me shërbime të ngjashme (llogari pagese me shërbime bazike).**